



## **BASHKIA E TIRANËS KËSHILLI BASHKIAK**

### **V E N D I M**

Nr. 10 datë 30/04/2014

### **PËR**

### **“KRIJIMIN E KËSHILLIT ARTISTIKO – KULTUROR DHE SHPËRBLIMIN E ANËTARËVE TË TIJ”**

Në mbështetje të nenit 10/3/II shkronja “a” dhe nenit 32 shkronja “ç” të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); nenit 121, pika 1, 124, pika 1, 125 të ligjit nr.8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative” (i ndryshuar); vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 540, datë 21.12.1992 për “Krijimin e Këshillave Artistiko – Kulturor dhe për shpërblimin e anëtarëve të tyre” (i ndryshuar); udhëzimit të Ministrit të Kulturës Rinisë dhe Sporteve nr.1, datë 24.05.2005 për “Mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Këshillave Artistiko – Kulturor”; vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 35, datë 15.03.2001 për “Miratimin e Rregullores mbi financimin e projekteve kulturore artistike dhe sportive”.

### **V E N D O S I**

1. Të miratojë përbërjen e Këshillit Artistiko – Kulturor, për periudhën 2014 –2016, me përbërje si më poshtë:

- |                      |   |
|----------------------|---|
| 1. ALI OSEKU         | Piktor  |
| 2. ILIR KERNI        | Drejtor i Teatrit Kombëtar të Operas dhe Baletit  |
| 3. PARID TEFERIÇI    | Shkrimtar, përkthyes dhe piktor   |
| 4. MELSI LABI        | Drejtor i Muzeut Historik Kombëtar  |
| 5. YLLKA MUJO        | Aktore  |
| 6. BUJAR SHEHU       | Trajner “Mjeshtër i Merituar Sporti”  |
| 7. MARJETA ZAÇE      | Pedagoge “Mjeshtër i Merituar Sporti”   |
| 8. MIÇO PAPADHOPULLI | “Mjeshtër Sporti”   |
| 9. YLLI TOMORI       | “Mjeshtër i Merituar Sporti”, “Mjeshtër i madh punës”,<br>Trajner i ekipit kombëtar të Volejbollit. |

2. Pagesa për çdo anëtar të Këshillit Artistiko-Kulturor është 4.500 (katër mijë e pesëqind) lekë për çdo mbledhje.
3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit dhe Promovimit të Qytetit si dhe Drejtoria e Artit dhe Kulturës për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

**KRYETARI**

**ALDRIN DALIPI**